



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Qeveria / Vlada / Government
Ministria e Digjitalizimit dhe Administratës Publike –
Ministarstvo digitalizacije i javne uprave - Ministry of Digitalization and Public
Administration

Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik - Odeljenje za upravljanje javnim
službenicima - Department for the Management of Public Officials

Njoftim për të drejtat politike

Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë ju njofton se, në përputhje me nenin 13 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë (LZP) dhe duke marrë parasysh zhvillimin e procesit zgjedhor për Kuvendin e Republikës së Kosovës, është e rëndësishme që të informoni të gjithë zyrtarët tuaj mbi të drejtat dhe kufizimet e tyre politike, siç përcaktohen në nenin 25 të këtij ligji:

E drejta për aktivitete politike dhe anëtarësim në parti politike:

- Zyrtari publik ka të drejtë të marrë pjesë në aktivitete politike dhe të shprehë bindjet e tij/saj partiake vetëm jashtë orarit zyrtar të punës dhe jashtë ambienteve të institucionit publik.
- Nëpunësi civil i kategorisë profesionale dhe specialisti mund të jetë anëtar i partive politike, por jo pjesë e organeve drejtuese qendrore ose komunale. Ndërsa nëpunësit civil të nivelit të ulët, mesëm apo lartë drejtuese nuk mund të jenë as anëtar të partive politike e as pjesë e organeve drejtuese qendrore ose komunale.
- Nëpunësi i shërbimit publik i kategorisë profesionale dhe specialisti si dhe nëpunësi teknik dhe mbështetës mund të jenë anëtarë të partive politike dhe anëtarë të organeve drejtuese të një partie politike. Ndërsa nëpunësit e shërbimit publik të nivelit të lartë, të mesëm dhe të ulët drejtues, mund të jenë anëtarë të partive politike, por nuk mund të jenë anëtarë të organeve drejtuese qendrore dhe komunale të një partie politike.

Obligimi për pezullimin e marrëdhënies së punës gjatë fushatës zgjedhore:

- Zyrtari publik që kandidon për deputet obligohet të pezullojë marrëdhënien e punës pa pagesë së paku shtatë (7) ditë para fillimit të fushatës zgjedhore dhe deri pesë (5) ditë pas përfundimit të saj. **Duke pasur parasysh se, sipas njoftimit të KQZ-së, fushata zgjedhore fillon më 28 maj 2026, pezullimi duhet të bëhet më së largu deri më 21 maj 2026. Meqenëse zgjedhjet mbahen më 7 qershor 2026, pezullimi zgjat deri më 12 qershor 2026.**

- Obligimi për pezullim të marrëdhënies deri në hapjen e fushatës vlen për të gjitha kategoritë e zyrtarëve publike që kandidojnë për deputetë (nëpunësin e shërbimit civil, nëpunësin e shërbimit publik, krijuesin dhe performuesin e artit dhe kulturës, nëpunësin teknik dhe mbështetës dhe zyrtarin e kabinetit).
- Ligji për Zyrtarët Publikë nuk zbatohet ndaj të zgjedhurve (deputetët dhe anëtarët e kuvendeve komunale), anëtarëve të Qeverisë dhe zëvendësve të tyre dhe të emëruarve në nivelin lokal dhe qendror (me përjashtim të zyrtarëve të kabinetit), prandaj të njëjtit nuk janë të obliguar që të pezullojnë vendin e punës gjatë fushatës.

Pezullimi i marrëdhënies së punës në rast të zgjedhjes si deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës

- Sipas nenit 25 (6) të LZP-së, në rast të zgjedhjes si deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, zyrtari publik, i cila pranon mandatin, pezullon marrëdhënien e punës prej datës së certifikimit të zgjedhjes së kandidatit deri në përfundim të mandatit përkatës. Përjashtimisht, pezullimi i marrëdhënies së punës në rast të zgjedhjes nuk zbatohet ndaj stafit akademik universitar (profesori i rregullt, profesori i asociuar, profesori asistent, profesori, ligjërues, asistent) dhe profesionistëve shëndetësor, të cilët kanë të drejtën të vazhdojnë të ushtrojnë pozitën pas certifikimit të rezultateve. Po ashtu, **pezullimi i vendit të punës nuk mund të bëhet për pozitat të cilat janë me mandat, pra për asnjë nga pozitat drejtuese në institucionet publike.**
- Pas përfundimit të mandatit, zyrtarit publik i garantohet rikthimi në marrëdhënie pune në institucionin ku ka qenë i punësuar ose në një institucion tjetër, në një pozitë të njëjtë ose ekuivalente, me kusht që të plotësojë kriteret e përcaktuara për atë pozitë.

Ky njoftim ka për qëllim të sigurojë zbatim të drejtë dhe të barabartë të ligjit për të gjithë zyrtarët publikë gjatë fushatë zgjedhore. Ju lutemi që ky informacion të shpërndahet tek të gjithë zyrtarët e institucionit tuaj.